



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.115/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kimete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjeti Balkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahën me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 30.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.115/2019 e datës 27.09.2019 e paraqitur nga Rrjeti Balkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter Neës Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 27.09.2019, me të cilën pretendon se kandidatja për kryeministre Vjosa Osmani, nga radhët e subjektit politik LDK, në postimin e sajë në rrjetin social Facebook, ka publikuar një video në të cilën përfshihën femijë nën moshën 15 vjeqare. Paraqitësi i ankesës pretendon se me këtë Vjosa Osmani, kandidat për kryeministre nga radhët e subjektit politik LDK, ka shkelur rregulloren e re 20/2019 për fushatën e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet, përkatësishtë nenin 5 paragrafi 3 pika d).

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një CD lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 28.09.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), thekson se ankesa e BIRN dhe IKS është e pa baze, pere arsye se pretendimet e tyre per shkelje te rregullores 20/2019 per fushaten e zgjedhjeve dhe njoftimit per ngjarjet, gjegjesishte nenin 5 pragrafi 3 pika d) nuke qendron nga se ne videon te cilen e ka shperndar kandidatja per kryeministre nga radhet e subjektit politik LDK, eshte e vertet se ne disa sekuenca te saje ka femije, pore kjo oshte ne perputhje me rregulloren 20/2019, gjegjesishte me nenin 1 apo nenin 5 paragrafi 5, i riformuluar pika h).Andaj, subjekti politik LDK i propozon PZAP-së që ankesa e BIRN dhe IKS te hudhet si e pa lejuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se subjekti politik LDK, dhe kandidatja e tyre për Kryeministre Vjosa Osmani lidhur me postimin e videos në facebook, me të cilën shihet se janë disa sekuenca me femije dëshmon se nuk bëhet fjale për video e cila ka shërbyer për të bërë apel për të votuar. Ne provat e bashkangjituara ne ankes nuk shihet qe subjekti politik LDK, ka dashur te promovoj programin politik gjatë fushatës zgjedhore sepse ne sekuenat e vidoes shihen vetem disa femijë te cilët nuk e kanë ndonjë identifikim të subjektit politik.

Pretendimet ankimore të parashtresit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të rregullës zgjedhore 20/2019 për fushatën e zgjedhjeve, përkatësisht nenin 5 par 3 pika d) nga ana e subjektit politik LDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të rregullës zgjedhore 20/2019 per ndryshimin dhe plotësimin e rregullës zgjedhore nr.13/2013 me te cilën neni 5 paragrafi 2 pika h) thuhet ; *Personat te cilët nuk i kane mbushur 18 vjet ne ditën e zgjedhjeve , përveç kur janë te shoqëruar nga prindërit e tyre apo me pëlqimin e prindërve*, gjë e cila është dëshmuar nga kandidati ne fjale.

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.115/2019 më datën 30.09.2019

Kryesuesi i Panelit

Zyhdi Haxiri



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*